



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.364, Datë 13.11.2023

PËR

“MIRATIMIN E VEPRIMTARISË JASHTË FUNKSIONIT PËR  
PROKURORIN ARIAN MUÇAJ”

Bazuar në nenet 143, 149/a, **germa “e”**, 149/ç, të Kushtetutës të Republikës të Shqipërisë, nenin 9 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 164, pika 8, nenin 189, pika 1, **germa “a”** të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenin 8 të Rregullores “Për veprimtaritë jashtë funksionit të prokurorëve”, si dhe pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e veprimtarisë jashtë funksionit për prokurorin Arian Muçaj, si ekspert për krimin kibernetik në Shqipëri, në kuadër të projektit UB 2023 “Mbështetje për avancimin e shtetit ligjor në Shqipëri – Faza IV” të OSBE-së, për 17 (shtatëmbëdhjetë) ditë pune gjithsej, 2 (dy) orë në javë brenda orarit zyrtar dhe 3 (tre) orë në javë jashtë orarit zyrtar.
2. Të njoftohen për këtë vendim zoti Arian Muçaj, Prokurori i Përgjithshëm dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
4. U shpall në Tiranë, sot më 13.11.2023.

ZV/KRYETAR

Tartar Bazaj

